



## Fondi Shqiptar i **INOVACIONIT**

Qëllimi i fondit është t'i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për NVM-të për të audituar nevojat e tyre për inovacion dhe teknologji, për të identifikuar furnizues teknologjicë dhe partnerë në shtete të tjera, të ndihmojë dhe lehtësojë promovimin dhe licencimin apo patentimin e inovacioneve të NVM-ve duke bërë të mundur që NVM-të përfituese të arrijnë më shumë nga sa ato do të mund të arrinin vetëm me mjetet e tyre.



# PËRFITUES TË FONDIT

- Biznes i klasifikuar si mikro, i vogël, apo i mesëm sipas ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar;
- Aftësia e ndërmarrjes për financim 100% të të gjithë kostove të projektit të propozuar, para përfundimit të tij;
- Ka selinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Prodhon në Shqipëri produkte dhe/apo shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;
- Kanë një projekt në përputhje me përcaktimet e VKM-së Nr.211 datë 20.04.2018.

## PROCEDURA E APLIKIMIT

Kërkesa paraqitet pranë AIDA-s nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij.

Formulari i aplikimit mund të shkarkohet nga faqja e internetit të AIDA-s [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al). Punonjësi i AIDA-s asiston aplikantin në plotësimin e formularit të aplikimit.

### APLIKANTI DUHET TË DORËZOJË DOKUMENTACIONIN E MËPOSHTËM:

- Akti i regjistrimit të subjektit sipas legjislacionit në fuqi (QKB);
- Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes;
- Në rastet kur bilanci është negativ, ndërmarrja duhet të dorëzojë një vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me buxhetin e projektit;
- Projekti i propozuar;
- Buxheti i projektit;
- Një dokument që vërteton se subjekti juaj:
  - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
  - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore;
- Evidenca për produktet/shërbimet e prodhuara ose që do të prodhohen;
- Dokument identifikimi, i njohur nga ligji, të personit që paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjes;
- Autorizim që vërteton se personi i cili paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjes, kur ky i fundit nuk është titullari i ndërmarrjes, është i autorizuar prej këtij subjekti për të aplikuar dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të ndërmarrjes.

# FINANCIMI

- Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 400.000 (katërqind mijë) lekë për një projekt. Për ndërmarrjet që do të aplikojnë për "blerje pajisjesh teknologjike" financimi do të jetë jo më shumë se 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.
- Skema mbulon 50% të kostove të pranuar brenda limitit të mësipërm.
- PAGESA E FONDIT TË PËRFITUAR BËHET 50% NË fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;

- Në një vit, mund të asistohet 1 projekt për çdo ndërmarrje;
- Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë në rast se fondi ka mbaruar;
- AIDA në faqen e saj të internetit do të publikojë gjendjen e disponueshmërisë së Fondit.

**Në rast se fondi ka mbaruar, pranimi i aplikimeve dhe miratimi i granteve mund të rifillojë vetëm pas plotësimit të SGK\* me fonde.**

\*Skema e Granteve Kombëtare

## SHPENZIMET E MBULUESHME

- Auditim të kapaciteteve inovative dhe teknologjike që synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante, vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi.
- Ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin.
- Pjesëmarrje në panairë inovacioni, teknologjive dhe promovimi në lidhje me inovacione të ndërmarrjes. Kostot e njohura në këtë rast do të jenë kosto udhëtimi, akomodimi, pjesëmarrje dhe stendë.
- Blerje pajisjesh teknologjike që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve inovative dhe teknologjike të ndërmarrjes.
- Kostot e licencave ose patentave (software ose hardware).

## SHPENZIMET E PAMBULUESHME

- Kosto të lindura para datës së nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Kosto komerciale, përfshirë përfaqësimin;
- Zbavitje dhe dhurata;
- Investim kapital;
- Prodhim, duke përfshirë kampionë;
- Kosto të ndërmarrjeve për stafin e tyre;
- Shpenzime administrative;
- Kosto të lindura në vazhdimësi prej strukturave dhe detyrimeve ekzistuese;
- Çdo aktivitet i paligjshëm;
- Pjesëmarrja në panairë të armatimit dhe teknologjisë ushtarake;
- Pjesëmarrja në panairë të teknologjisë së duhanit.

Aplikimet do të vlerësohen nga Komisioni i Aprovimit të Grantit (KAG) i cili do të mbledhet sipas kërkesave të paraqitura të paktën 6 herë në vit.

Vendimi për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazohet vetëm mbi dokumentet e paraqitur. KAG gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi merr në konsideratë kriteret e paraqitura në rregulloren e Fondit. Aplikantët e refuzuar do të informohen në lidhje me shkaqet e refuzimit.



Adresa:  
Blv. "Dëshmorët e Kombit",  
Kryeministria, Kati III, Tiranë

website: [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al)  
email: [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al)  
Tel: +355 042 251001